33.4 Pas pranimi të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimi siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i implantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimit përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektit dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta lirojë vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 623-24-5118-5-2-1/C638

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10 % të vlerës së kontratës , për kohëzgjatjen e periudhës prej: 25 Muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë e tyre, Impianteve dhe Materialeve gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuar sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është: 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhjeve është i pakufizuar; (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim, personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhjeve është i pakufizuar, (ii) të personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhjeve është i pakufizuar,
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda: 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është: 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të Projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë nga dita e caktuar në Planin e Menaxhimit nga Menaxheri i Projektit.
	17.2	Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonësive të lejuara nga organi mbikëqyrës. Kontrata është: 24 Muaj
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është: 10 % e Çmimit final të Kontratës
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në Vend – Punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve të përgjithshme të kontratës. Menaxheri i Projektit do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim nga Zyratari Kryesor Administrativ (ZKA)

Pagesat	24.1	Pagesat do të bëhen në Euro. Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacion.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: Nuk aplikohet.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10 % të vlerës së kontratës Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi me kërkesë mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me Polisë të sigurimit apo dokument bankar i lëshuar nga ndonjë Kompani e Sigurimeve apo Bankë e Licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës, prej 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës me afat validiteti prej: 24 muaj, nga data e lëshimit të certifikatës për pranimit të përkohshëm të punimeve. Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve: 24 muaj
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë: 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është: 24 muaj . Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të punëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është: përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Rahovecit
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.

Aneksi - 6.I

PERIUDHA GARANTUESE

Për: **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**

(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: **[BAZALTI-S SH.P.K & N.N.P Ndërtimi & D & T Group SH.P.K & N.N.P EURO**

CONSTRUCTION -Adresa: Dobidol, Shaban Jashari pn – Rahovec]

(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **NDËRTIMI I URAVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**

Numri i Prokurimit: 623-24-5118-5-2-1

Deklaratë e Operatorit Ekonomik për Periudhën Garantuese

DERISA ne si tenderues kemi ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një ofertë në të cilën kriter i dhënies është Tenderit Ekonomikisht Më i Favorshëm (TEMF), bazuar në nën kriteret për PERIUDHËN GARANTUESE, DEKLAROJMË se do të përmbushin kërkesat e Autoritetit Kontraktues për këtë projekt për një periudhat e përcaktuara si më poshtë:

I.PERIUDHA GARANTUESE vlen 24 muaj nga data e pranimit të përkohshëm të projektit

Shëno numrin e viteve

nga Autoriteti Kontraktues, për projektin e cekur në këtë deklaratë.

KADRI THAQI

Emri i përfaqësuesit të OE



Nënshkrimi



**PARAMASA DHE PARALLOGARIA
NDËRTIMI I URAVE PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**



Pjesë përbërëse e paramasës janë edhe: PËRSHKRIMI TEKNIK I PUNIMEVE, PROJEKTI, DETALET, SKEMAT GRAFIKE DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE. Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me liber ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.

Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtes. Pra në këtë mënyrë duhet të bëhet sigurimi i punishtes dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësinore në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve.

Punishlja të shenjëzohet dhe të vendosen tabela prej llamarine dhe me konstruktion të përfunduar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheh edhe çkqjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konservimin të instalimeve ekzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.

URA RATKOC					
A					
1	PUNËT PREGADITORE				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
1.1	Ndërtimi i kantierit dhe mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes së makinave dhe stafit punues.	Komplet	1.00	500.00	500.00
1.2	Sinjalizimi i punishtes (sipas standardeve të ndërtimit), hyrje daljet në punishte, rrugët për qasjen dhe qarkullimin e materialeve, duke parapar edhe montimin e tabelës informuese (llamarinës dhe me konstruktion të përfunduar mirë në tokë) me emrin e projektit, investitorit, punëkryesit, vlera e investimeve, data e fillimit të punimeve si dhe data e mbarimit të punimeve. Në çmim të merren parasysh edhe shenjat lajmeruese për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë.	Komplet	1.00	100.00	100.00
1.3	Incizimi dhe fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperëve të rrjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kaloj rruga dhe kontrollimi niveleve të ures sipas projektit.	m ²	650.00	0.50	325.00
7.5	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore. Në rastin e paraqitjes së instalimeve nëntoksore, punmarrësi duhet të hartoj planin detal për zgjidhjen e problemeve. Zgjidhja e dhënë aprovet nga organi mbikqyrës dhe i bashkangjitet projektit detal. Në çmim të llogaritet përpilimi i planit dhe shpenzimet e tjera. Instalimet nëntoksore nënkuptojnë (rrjeti elektrik, ujsjellesin, kanalizimin, ujitjes etj).	m'	100.00	1.00	100.00
1.5	Demolimi urës ekzistuese me mekanizëm përkatës me të gjitha elementet e sajë (themel plakat, muret mbajtëse, pllakën e mbistrukturës, pllakat kaluese, kokat hyrëse dhe dalëse, parkmakun nga çeliku etj). Ura ekzistuese është e punuar nga materiali beton-arme. Dimenzionet e urës ekzistuese janë: Gjerësia B=6.50 m, gjatësia L=10.0 m dhe lartësia H=2.50 m. Në çmim duhet të kalkulohet edhe transporti i materialit deri në deponi 10 km largësi ku e cakton organi mbikqyrës	Copë	1.00	500.00	500.00
1.6	Prerja dhe demolimi i asfaltbetonit dhe bitozhavorit në pjesët në afërsi ku do të ndërtohen urat me makineri përkatëse duke përfshirë edhe shtresat e tamponit. Në çmim të kalkulohet edhe largimi i materialit deri në deponi 10 km largësi, ku e cakton organi mbikqyrës.	m ²	300.00	2.00	600.00
TOTALI POSICIONI:1					2,125.00

2	STRUKTURA E RRUGËS SË PËRKOHËSHME				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
2.1	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e materiali për mbushjen e nevojshme në trasen e rrugës së perkohëshme të mirret prej huazishtës ose lumit me kualitet DN 18196 dhe struktur zhavorri GE apo rërë SE dhe shpërndarje.	m ³	112.00	4.00	448.00
2.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së rrugës prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=20cm me strukturë të shpërndarë sipas rregullores gjermane ZTV për shtresat mbajtëse të rrugëve, ndërsa moduli i ngjeshjes Ev2 duhet të jetë ≥45MN/m ² .	m ³	56.00	8.00	448.00

2.3	Devijimi i shtratit të lumit gjatë ekzekutimit të punimeve, largimi i sasisë së ujit një here ana e djathtë, pastaj ana e majtë, apo anasjelltas, dhe të punohet në gjendje të terur pa prezencën e ujit. Në çmim përfshihen të gjitha punët dhe materialet për largimin e ujit.	Komplet	1.00	200.00	200.00
2.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave të betonit Ø1000mm për qarkullim të ujit nga njera anë e rrugës në tjetren.	m'	20.00	75.00	1,500.00
TOTALI POSICIONI:2					2,596.00
3	PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
3.1	Gërmimi i dheut të kategorisë III, IV me ngarkim dhe bartje deri në depozitë të cilën e cakton organi mbikqyrës. Sasia e llogaritur në gjendje natyrale.	m³	1,050.00	1.00	1,050.00
3.2	Gërmimi i dheut të kategorisë së III- IV-të për hapjen e themeleve sipas thellësisë së fundimit në projekt.	m³	126.00	1.50	189.00
3.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e materialit (gurë i thyer fr. 60/120 mm) nën tabanin e themeleve me trashësi d=50 cm me kompaktësim dhe me matje të ngjeshmerisë me modul 40 Mpa.	m³	34.02	4.50	153.09
3.4	Furnizimi, transporti, dhe punimi i shtresës së zhavorit 0-63mm nën pllakat kaluese dhe mbi konstruksionin e rrugës me trashësi t=30cm. Zhavori vendoset në shtresa nga 20.0cm, ndërsa moduli i ngjeshjes Ev2 duhet të jetë ≥65MN/m².	m³	123.75	7.00	866.25
3.5	Furnizimi, transporti, dhe punimi i shtresës së zhavorit 0-31.5mm me trashësi 15.0cm, mbi pllakat kaluese (struktura e rrugës), ndërsa moduli i ngjeshjes Ev2 duhet të jetë ≥65MN/m².	m³	66.38	8.00	531.00
3.6	Furnizimi, transporti, mbushja dhe ngjeshja (në shtresa çdo 30 cm) me material rrethor koheziv (zhavor natyral), për shtyllat bregore dhe nivelizim të rrugës afër urës.	m³	192.30	4.00	769.20
TOTALI POSICIONI:3					3,558.54
4	PUNËT E ASFALTIT				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
4.5	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shtresës së Bitu-Agregatit të llojit BA 22 të aksit të rrugës sipas profileve tërthore, me shtresë me trashësi 8.0 cm.	m²	300.00	8.00	2,400.00
4.4	Furnizimi, transporti dhe spërkatja me emulsion 0.1-0.40 kg/m2, në mas të dy shtresave (Asfalt Betonit dhe Bitu Agregatit)	m²	300.00	0.80	240.00
4.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shtresës nga Asfalt Betoni i llojit AB16 të aksit të rrugës, sipas profileve tërthore me shtresë me trashësi 5.0cm.	m²	300.00	12.00	3,600.00
TOTALI POSICIONI:4					6,240.00
5	PUNËT E BETONIT				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
5.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit të varfër me klasë C-12/16 nën tabanin e themelit me trashësi d=10 cm.	m³	9.48	55.00	521.51
5.2	Furnizimi, transporti, kallëpimi dhe betonimi i themel pllakave me klasë të betonit C-35/45. Betoni duhet të jetë i papërshkrueshem nga uji, të punohet me shtesa (Mapefluid N200) ose material i ngjashem me cilësi të dëshmuara .	m³	41.15	65.00	2,674.67
5.3	Furnizimi, transporti, kallëpimi dhe betonimi i mureve anesore (kraheve paralel të ures) me klasë të betonit C-35/45. Betoni duhet të jetë i papërshkrueshem nga uji. Betoni punohet me shtesa Mapefluid N200 ose material të ngjashem me cilësi të dëshmuar .	m³	15.44	65.00	1,003.86
5.4	Furnizimi, transporti, kallëpimi dhe betonimi i shtyllave (Mureve) mbajtëse të ures së bashku me elementin e shkurtër, me klasë të betonit C-35/45. Betoni duhet të jetë i papërshkrueshem nga uji. Betoni punohet me shtesa Mapefluid N200 ose material të ngjashem me cilësi të dëshmuar .	m³	33.18	65.00	2,156.44

5.5	Furnizimi, transporti, kallëpimi dhe betonimi pllakës së mbistruktues me klasë të betonit C-35/45. Betoni duhet të jetë i papërshkrushem nga uji. Betoni punohet me shtesa Mapelluid N200 ose material të ngjashem me cilësi të dëshmuar .	m ³	63.36	65.00	4,118.40
5.6	Furnizimi, transporti, kallëpimi dhe betonimi shtegut për këmbësor me klasë të betonit C-30/37. Betoni duhet të jetë i papërshkrushem nga uji. Betoni punohet me shtesa Mapelluid N200 ose material të ngjashem me cilësi të dëshmuar .	m ³	9.68	65.00	629.20
5.7	Furnizimi, transporti, kallëpimi dhe betonimi i pllakave kaluese me klasë të betonit C-30/37. Betoni duhet të jetë i papërshkrushem nga uji. Betoni punohet me shtesa Mapelluid N200 ose material të ngjashem me cilësi të dëshmuar .	m ³	5.74	65.00	373.23
TOTALI POSICIONI:5					11,477.31
6	PUNËT E ARMIMIT				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
6.1	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe vendosja e armatures sipas detaleve në projekt për të gjitha elementet e urës, me klas S-500. Në çmim të kalkulohet komplet për kg.	kg	22,995.00	0.65	14,946.75
TOTALI POSICIONI:6					14,946.75
7	PUNIMI I SHTRATIT TË LUMIT				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
7.1	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperëve të rrjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kaloj lumi si dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik.	m'	100.00	1.00	100.00
7.2	Hulumtimi dhe pastrimi i terenit, rrënimi i gërmadhave dhe mbeturinave, prerja e drunjëve, cungave të ndryshëm, shkurrave të vjetra si dhe pastrimi i lokacionit për ndërtimet e reja. Në çmim të kalkulohet pastrimi komplet trases ndërtuese me ngarkim dhe transporti deri në deponin më të afërt të caktuar nga organi mbikëqyrës (në të dy anët e lumit).	m ²	720.00	2.00	1,440.00
7.3	Devijimi i shtratit të lumit gjatë ekzekutimit të punimeve, largimi i sasisë së ujit një here ana e djathtë, pastaj ana e majtë, apo anasjelltas, dhe të punohet në gjendje të terur pa prezencën e ujit. Në çmim përfshihen të gjitha punët dhe materialet për largimin e ujit.	m'	100.00	9.00	900.00
7.4	Përdorimi i pompave për largim të ujrave gjatë kryerjes së punëve ndërtimore (sipas nevojës).	Orë	30.00	10.00	300.00
7.5	Gërmimi i dheut (baltës) në fundin e lumit dhe gërmimi i humusit në brigjet e lumit. Në çmim të llogaritet transportimi deri në deponin e përcaktuar nga Organi mbikëqyrës në largësi deri në 10 km.	m ³	120.00	4.00	480.00
7.6	Gërmimi i dheut (kategoria III-IV) dhe materialeve tjera me makinë në vendpunim, në tërë sipërfaqen e profilave të rregulluar sipas projektit. Humusit i shëndosh duhet të ruhet, kurse materiali i panevojshëm të bartet deri në deponinë më të afërt, të caktuar nga organi mbikëqyrës, gjithnjë sipas dispozitave udhëheqëse të organit mbikëqyrës.	m ³	384.00	2.50	960.00
7.7	Furnizimi, transporti dhe përgatitja e shtresave mbajtëse nga guri i thyer fraksion 0-63 mm, sipas profileve tërthore me shtresa me trashësi d=25 cm duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues.	m ³	200.00	7.00	1,400.00
7.8	Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorit 0-31.5 mm sipas profileve tërthore me trashësi d=20 cm në gjendje të ngjeshur. Materiali duhet të jetë i përshtatshëm për planifikim në teren të pjerrët. Gjithnjë sipas detaleve në projekt.	m ³	160.00	8.50	1,360.00
7.9	Furnizimi, transporti dhe vendosja e gjeotekstilit nën shtresën e zhavorit, 300gr/m2 (vendosja sipas detalit).	m ²	1,000.00	0.85	850.00
7.10	Furnizimi, transporti dhe vendosja e dheut (materialit mbushës) nga deponia e dheut të cilën e cakton organi mbikëqyrës (me dhe kualitativ). Në çmim duhet të llogaritet: gropimi në deponi, transporti deri në trasë, shpërndarja, ngjeshja e dheut deri në trusninë natyrale (nëse duhet edhe të laget me ujë, ose edhe të thatet), planifimi i tij dhe ngjeshje 60 MN/m2 me CBR>5%.	m ³	230.40	2.50	576.00

7.11	Formimi i skarpave dhe i fundit të shtratit të lumit sipas vizatimit me saktësi prej (+,-) 3 cm dhe gjuajtja e dheut dhe ngjeshja me mjetet e transportit.	m²	850.00	1.50	1,275.00
7.12	Furnizimi, transporti dhe betonimi i pragjeveve në hyrje dhe dalje të shtratit të rregulluar të lumit nga betoni armuar me klase C-25/30. Në çmim të kalkulohet edhe armatura për shtangim dhe shtresa e rërës nën beton sipas detalit ne projekt.	m³	11.20	65.00	728.00
7.13	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtratit të lumit në pjesët e pjerrta(skarpatave) dhe bazës së lumit me gurë me trashësi minimale t=(15-20)cm dhe mbushja e fugave me llaç çimentoje 1:3:9. Vendosja e gurëve rrasor bëhet në shtresë betoni C-20/25, t=15cm. (Ekzekutimi sipas detaleve në projekt).	m²	880.00	5.00	4,400.00
TOTALI POSICIONI:7					14,769.00
8	PUNËT E GYPAVE TË UJIT				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
8.1	Furnizimi, transporti dhe instalimi i gypave të ujësjellësit dhe ujitjes HDPE100 RC . Në çmim duhet të llogariten të gjitha pjesët fazonike.				
8.1.1	HDPE 100 RC SDR 17-C8, Ø110/PN 16bar.	m'	65.00	15.00	975.00
8.1.2	HDPE 100 RC SDR 17-C8, Ø75/PN 16bar.	m'	110.00	20.00	2,200.00
TOTALI POSICIONI:8					3,175.00
9	PUNËT TJERA				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
9.1	Vendosja e katër gypave PESN8 Ø100 per instalime e rrymave të forta dhe të dobëta me elementet përcjellese sipas dizajneve grafike .	m'	48.00	2.50	120.00
9.2	Hidrolizimi horizontal dhe vertikal i pllakës së mbistruktures dhe mureve mbajtës të urës. "Betagum-Elastoplastomeric modified" me t=5 mm në dy shtresa ose prodhim tjetër me karakteristikë teknike të njeta ose më të mira . Para vendosjen se izolimit sipërfaqja duhet pastruar mir dhe të lyhet me bazë bituliti.	m²	109.10	2.50	272.75
9.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e skajoreve mbi bazë e betoni (C 16/20), skajore betoni me dim. 18x24x100cm nga betoni C-35/45MPa sipas detaleve në projektë.	m'	24.00	10.00	240.00
9.4	Furnizimi, transporti, montimi dhe ngjyrosja e parmakut metalik sipas detaleve në projekt. Në çmim të kalkulohet komplet me bullona për ankerim, pllaken mbështetëse, të llogaritet komplet për meter gjatësi.	m'	24.00	10.00	240.00
9.5	Furnizimi, transporti dhe punimi i sinjalizimit horizontal në rrugë me ngjyrë të bardhë solide një komponentëshe reflektuese, me përqëndrim të ulët të tretësisil. Vija të bardha të nderprera (3.0+1.0+3.0 m, me gjersi 120 mm), aksi i mesit të rrugës.	m'	50.00	4.00	200.00
9.6	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) e shenjes së trafikut "Kallmi mbi Urë" (dimensionet: 600x600 mm)	Copë	2.00	68.00	136.00
9.7	Pas ekzekutimit të punimeve të urës duhet të bëhet rehabilitimi i terenit (rikrithimi i terenit përreth në gjendjen e mëparëshme). Pas demolimit të rrugës së perkohëshme, me materialin e mbetur duhet të rregullohen argjinatural e Lumit. Demolimi i rruges së perkohëshme dhe rregullimi i argjinaturave të lumit të kalkulohet komplet.	Komplet	1.00	50.00	50.00
TOTALI POSICIONI:9					1,258.75
A					
Nr.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT				SHUMA TOTALE
1	PUNËT PREGADITORE				2,125.00
2	STRUKTURA E RRUGËS SË PËRKOHËSHME				2,596.00
3	PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT				3,558.54
4	PUNËT E ASFALTIT				6,240.00
5	PUNËT E BETONIT				11,477.31
6	PUNËT E ARMIMIT				14,946.75
7	PUNIMI I SHTRATIT TË LUMIT				14,769.00
8	PUNËT E GYPAVE TË UJIT				3,175.00
9	PUNËT TJERA				1,258.75
TOTALI A :					60,146.35

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA
NDËRTIMI I URAVE PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**

Pjesë përbërëse e paramasës janë edhe: PËRSHKRIMI TEKNIK I PUNIMEVE, PROJEKTI, DETALET, SKEMAT GRAFIKE DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE. Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe alesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me libër ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.

Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtes. Pra në këtë mënyrë duhet të bëhet sigurimi i punishtes dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësinore në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Punishlja të shenjëzohet dhe të vendosen tabela prej llamarinë dhe me konstrukcion të përforcuar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheh edhe çkyqjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikyqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konzervimin të instalimeve ekzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.

B		URA RAHOVEC			
1	PUNËT PREGADITORE				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
1.1	Ndërtimi i kantierit dhe mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes së makinave dhe stafit punues.	Komplet	1.00	1,000.00	1,000.00
1.2	Sinjalizimi i punishtes (sipas standardeve të ndërtimit), hyrje daljet në punishte, rrugët për qasjen dhe qarkullimin e materialeve, duke parapar edhe montimin e tabelës informuese (llamarinës dhe me konstrukcion të përforcuar mirë në tokë) me emrin e projektit, investitorit, punëkryesit, vlera e investimeve, data e fillimit të punimeve si dhe data e mbarimit të punimeve. Në çmim të merren parasyshe edhe shenjat lajmeruese për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë.	Komplet	1.00	200.00	200.00
1.3	Incizimi dhe fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperëve të rrjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kalojë rruga dhe kontrollimi niveleve të ures sipas projektit.	m ²	250.00	0.50	125.00
1.4	Largimi i gypave ekzistues të betonit dhe demolimi elementeve tjera nga materiali beton arme, thyerja e betonit si dhe transporti i tyre deri në deponi 10 km largësi ku e cakton organi mbikqyrës.	Copë	1.00	50.00	50.00
TOTALI POSICIONI:1					1,375.00

2	NDËRTIMI I RRUGËS SË PËRKOHËSHME				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
2.1	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e materiali për mbushjen e nevojshme në trasen e rrugës së perkohëshme të mirret prej huazishtes ose lumit me kualitet DN 18196 dhe struktur zhavorri GE apo rërë SE dhe shpërndarje.	m ³	88.00	5.00	440.00
2.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së rrugës prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=15cm me strukturë të shpërndarë sipas rregullores gjermane ZTV për shtresat mbajtëse të rrugëve, ndërsa moduli i ngjeshjes Ev2 duhet të jetë ≥45MN/m ² .	m ³	33.00	9.00	297.00
2.3	Devijimi i shtratit të lumit gjatë ekzekutimit të punimeve, largimi i sasisë së ujit një here ana e djathtë, pastaj ana e majtë, apo anasjelltas, dhe të punohet në gjendje të terur pa prezencën e ujit. Në çmim përfshihen të gjitha punët dhe materialet për largimin e ujit.	Komplet	1.00	250.00	250.00
2.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave të betonit Ø1000mm për qarkullim të ujit nga njëra anë e rrugës në tjetren.	m'	15.00	75.00	1,125.00
TOTALI POSICIONI:2					2,112.00

3	PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
3.1	Gërmimi i dheut të kategorisë III, IV me ngarkim dhe bartje deri në deponin të cilën e cakton organi mbikqyrës. Sasia e llogaritur në gjendje natyrale.	m ³	212.50	2.00	425.00
